



Me. H. prot
08. 24/04/26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 13, datë 20.04.2026

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIM TË LEJES/AUTORIZIMIT,
LIDHUR ME RINOVIMIN E LEJES NR. SERIAL 000137 “LEJE PËR
PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME TË
NDRYSHME”, TË SUBJEKTIT “MARE ADRIATIK” SH.P.K.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujqor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovim të lejes/autorizimit, lidhur me rinovimin e lejes Nr. Serial 000137, “Leje për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime të ndryshme (larja e peshkut të kriposur, larja e enëve, qëllime sanitare), miratuar me Vendim të Këshillit të Basenit Ujqor Drin-Bunë me Nr.8, datë 19.03.2021”, të subjektit “Mare Adriatik” sh.p.k, me vendndodhje: Bashkia Vau Dejes, Qarku Shkodër.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH):

X= 466871 Y= 4650413 Z= 8 m.m.n.d

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për qëllime të ndryshme (larja e peshkut të kriposur, larja e enëve, qëllime sanitare).

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 0.45 \text{ l/s}$

$Q_{mes} = 0.45 \text{ l/s}$

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Ujërat e Lumit Drin

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

KRYETARI I KBL DRIN-BUNË



HOLTA DUDA